



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 01-80  
Datë: 16.02.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2016 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet **Shkolla Digjitale në Prishtinë dhe Ferizaj**, për periudhën **08.12.2016** deri **30.09.2019** për të ofruar kualifikime të validuara në KKK:

1.1. **PROGRAMER JUNIOR; Niveli I sipas KKK,**

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- 2.1 Të vendosen njoftimet zyrtare se "jeni nën vëzhgimin e kamerave".
- 2.2 Kutia e ankesave/sugjerimeve të jetë në një sipërfaqe që nuk fokusohet nga kamera
- 2.3 Në objektin në Ferizaj, në katin e parë të ofrohet qasje për personat me karroca
- 2.4 Të licencohet sistemi operativ Windows ose të gjendet ndonjë zgjidhje për licenca falas
- 2.5 Në buxhetin vjetor të ketë planifikuar linjën buxhetore për zhvillimin profesional të stafit.
- 2.6 Të ketë auditime të pavarura, së paku një herë në vit, ashtu siç përcaktohet edhe me udhëzimet e AKK-së.
- 2.7 Të ketë procedurë të shkruar për ruajtjen e të dhënave, arkivimin e tyre dhe kohëzgjatjen e ruajtjes.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën **01.09.2017**, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

### **Arsyetim**

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

#### Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi u dërgohet:
  - Shkolla Digjitale;
  - AKK.

  
Anëtar i KD së AKK-së  
Bedri Xhafa